

NJOFTIM PËR VEND TË LIRË

PUNE

STAF AKADEMIK

Pozicioni: Lektor/Asistent-lektor në Departamenti e Inxhinierisë Kompjuterike

Tipologjia: Me kohë të plotë

Data e fillimit: Tetor 2024

Afati i aplikimit: 10/09/2024

Rreth UMT

Universiteti Metropolitan Tirana është universitet i certifikuar nga MAS i përbërë nga tre fakultete: Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës, Fakulteti i Ekonomisë dhe Fakulteti i Shkencave Kompjuterike dhe IT.

I klasifikuar si një nga universitetet më të mirë në Shqipëri, një rëndësi e veçantë i është dhënë kohët e fundit krijimit të një ekosistemi ndërmarrjesh, inovacionit pedagogjik si dhe strukturimit të aktiviteteve shkencore rreth shkollave të doktoratës në bashkëpunim me institucione dhe kolegë nga Evropa dhe SHBA.

Pozicioni vakant

Universiteti Metropolitan Tirana po kërkon të rekrutojë një Lektor/Asistent-Lektor në fushën e inxhinierisë së software-it, programimit dhe algoritmikes

Kriteret kryesore për të aplikuar për pozicionin janë si më poshtë:

- Të ketë përfunduar arsimin e lartë, bachelor dhe master shkencor në Inxhinieri Kompjuterike, Shkenca Kompjuterike, Informatike apo degë të ngjashme.
- Të ketë interes në kërkim shkencor dhe zhvillim profesional në fushën akademike.
- Të ketë aftësi të forta organizative dhe bashkëpunuese.
- Të ketë aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur dhe në bashkëpunim me anëtarët etjerë të ekipit.
- Të ketë aftësi të shkëlqyera komunikuese.
- Përparësi do të kenë kandidatët të cilët kanë:
 - gradë shkencore, ose në proces doktoratë në këtë fushë.
 - eksperiencë në mësimdhënie dhe kërkim shkencor.

Aplikimi

Kandidatët duhet të dërgojnë në format elektronik dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kërkesë me shkrim.
- CV (Curriculum Vitae) përfshirë listën e botimeve shkencore dhe referimeve në konferenca shkencore brenda ose jashtë vendit.
- Kopje e diplomës dhe listës së notave të nivelit “Bachelor” dhe “Master i Shkencave”.
- Nëse është student i një programi të ciklit të tretë të studimeve “Doktoratë”, vërtetim nga institucioni ku ndjek programin e studimit.
- Për pozicionin “Lektor”, dëshmi e titullit “Doktor i Shkencave” apo tituj të tjerë akademikë.

(*) Për diplomat e marra në universitetet e huaja, duhet të dorëzohet fotokopje e noterizuar e certifikatës së njohjes nga organi kompetent (MASR), ose vërtetim që janë në proces njohje.

Aplikimet duhet të dorëzohen me e-mail në humanresources@umt.edu.al